



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 8, datë 11.10.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “KOMPLEKSI BLEGTORIAL
“BUTRINTI FERM”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SARANDË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Butrinti Ferm” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleksi Blegtorial “Butrinti Ferm”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Butrinti Ferm” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) konvertimit të zërit kadastral nga “arë” në “trual” sipas legjislacionit sektorial në fuqi;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Sarandë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETARI KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

